



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.48/2017

Prishtinë, më 13 shkurt 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Nenad Rashedi, Mytaher Haskuka dhe Kujtim Paqaku.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinatori i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Florije Kryeziu, Ardian Klaiqi dhe Timur Ramiqi- UNICEF, Donjeta Kelmendi-KOMF, Kaltrina Rexhepi-BIRN, Alketa Lasku-Terre Des Hommes, Vebi Mujku-QPS Prishtinë, Ahmet Rushiti, Agnesa Haxhiu-KDI, Mërgime Tahirukaj- Radio Kosova.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj në vazhdim, Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës.

1.Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës

Kryetarja, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, ia dha fjalën kryesueses së grupit punues, znj. Mexhide Mjaku-Topalli.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se po fillojmë prej nenit 9, aty ku kishim mbetur në mbledhjen e 8 shkurtit 2017 dhe prezantoi propozim-amendamentet për nenet, me radhë.

Në nenin 9, u propozua të amendamentohet paragrafi 1, ndërsa paragrafi 2, të fshihet.

Neni 10, u propozua amendamenti i titullit.

Neni 11, u propozua të riformulohet titulli, të amendamentohet paragrafi 2, dhe pas paragrafit 5, të shtohet një paragraf i ri dhe paragrafi 8, të fshihet.

Neni 12, u propozua të amendamentohet paragrafi 2 dhe të riformulohet paragrafi 6.

Neni 13, u propozua të riformulohet paragrafi 5.

Neni 14, u propozua të riformulohet paragrafi 1.6, të amendamentohet paragrafi 1.8, dhe pas paragrafit 1.9 të projektligjit, të shtohet një paragraf i ri 1.10, paragrafi 1.10 i nenit të projektligjit, të bëhet paragraf 1.11.

Neni 16, u propozua të amendamentohet paragrafi 2, 3 dhe 4, të fshihet paragrafi 8, ndërsa pas paragrafit 9 të projektligjit, u propozua të shtohen dy paragrafë të rinj, paragrafi 10 dhe 11.

Neni 17, u propozua të amendamentohet titulli.

Neni 18, u propozua të amendamentohet paragrafi 3.

Neni 20, u propozua të amendamentohet paragrafi 1 dhe 2.

Neni 21, u propozua të riformulohet paragrafi 3.

Neni 24, u propozua që pas paragrafit 3 të projektligjit, të shtohet paragraf i ri 4, ndërsa paragrafi 4 i projektligjit të bëhet paragraf 5 dhe radhitja të bëhet sipas numrave me radhë, ndërsa të amendamentohet paragrafi 4.2 i nenit në projektligj.

Neni 25, u propozua të riformulohet paragrafi 1 dhe 2.

U propozua që pas nenit 25 të projektligjit, të bartet përmbajtja e neneve 32, 35 dhe 33, dhe pastaj radhitja e neneve të bëhet sipas numrave me radhë.

Neni 26, u propozua amendamenti teknikisht i titullit dhe nenit.

Komisioni debatoi për nenet 12 dhe 13, por u vendos që, pasi Komisioni do të ketë vizitë zyrtare në Shqipëri, atëherë të diskutohet edhe për këtë dhe të shikohen edhe praktikat e tyre dhe pastaj të vendoset se a do të mbetet përgjegjësia e zbatimit në ZQM, MPMS, Këshillin Ndërmnistror apo të formohet një agjenci e veçantë.

Komisionit, po ashtu, kishte debat edhe për nenin 15, Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit për Mbrojtjen e Fëmijës, lidhur me propozimin që në të ardhmen, njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit, të caktohet zëvendësavokat për mbrojtjen e fëmijës. Për këtë u vendos të analizohet mundësia dhe të konsultohet edhe Avokati i Popullit, në mënyrë që mos të bie ndesh me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Komisioni shqyrtoj propozim-amendamentet e propozuara nga grupi punues, deri te neni 26 i projektligjit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI